

9 mars 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 09.03.2026, Prishtinë

Konkurs për organizimin e Final Four – Liga Unike Femrat, edicioni 2025/26

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht neni 24, më 09.03.2026, Bordi i FBK-së shpall konkurs për organizimin e turneut Final Four – Liga Unike Femrat për edicionin 2025/26.

Bordi i FBK-së vendos si në vijim:

I. Turneu Final Four – Liga Unike Femrat për edicionin 2025/26 do të zhvillohet më **17 dhe 18 mars 2026**, në qytetin e organizatorit të përzgjedhur.

II. Të drejtë aplikimi për organizimin e turneut kanë të gjithë personat juridikë që përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë konkurs.

III. Organizatori i përzgjedhur do të nënshkruajë kontratë me FBK, në të cilën do të përcaktohen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe obligimet e të dyja palëve lidhur me organizimin e eventit.

IV. Organizatori i përzgjedhur obligohet të sigurojë:

- Kushte optimale për zhvillimin e ndeshjeve në përputhje me Rregullat Zyrtare të Basketbollit të FIBA-s, Propozicionet e Garave të FBK-së dhe aktet e tjera normative në fuqi;
- Palestër që përmbush standardet e kërkuara për zhvillimin e ndeshjeve të Final Four;
- Akomodimin (hotel) për të gjitha ekipet pjesëmarrëse dhe zyrtarët e ndeshjeve gjatë zhvillimit të turneut;
- DJ, sistem profesional të zërimit, fotograf zyrtar dhe spiker për ndeshjet;
- Pajisjet dhe logjistikën e nevojshme për ceremoninë përmbyllëse të eventit;
- Prezencë të mjaftueshme të forcave policore dhe sigurimit privat për garantimin e sigurisë së lojtarëve, stafit, zyrtarëve dhe spektatorëve;
- Promovimin dhe reklamimin e eventit në nivel lokal përmes mediave dhe rrjeteve sociale.

V. FBK do të mbulojë dhe organizojë:

- Transmetimin televiziv të ndeshjeve;
- Vendorsjen e reklamave LED në palestër;
- Pagesën e referëve dhe zyrtarëve të ndeshjeve;
- Kampanjën qendrore të promovimit dhe marketingut të eventit;
- Organizimin e ceremonisë përmbyllëse;

- Angazhimin e stafit organizativ të FBK-së gjatë eventit;
- Sigurimin e kupave dhe medaljeve për ekipet finaliste;
- Shpërblimet financiare për ekipet nga Kosova, sipas rregulloreve në fuqi.

VI. Gjatë zhvillimit të turneut Final Four – Liga Unike Femrat, do të organizohet edhe **Klinika e Referëve për Femra**, e organizuar nga FBK në bashkëpunim me FIBA Europe, ndërsa përgjegjësia financiare për organizimin e kësaj klinike do të mbulohet nga FBK.

VII. Organizatori i përzgjedhur do të ketë të drejtën e:

- Shitjes së biletave për eventin;
- Përdorimit të hapësirave për sponsorë dhe reklama brenda palestrës;
- Organizimit të aktiviteteve shtesë në kuadër të eventit, me miratimin paraprak të FBK-së.

VIII. Konkursi për organizimin e turneut mbetet i hapur për **3 (tri) ditë** nga dita e shpalljes.

IX. Aplikimet duhet të dorëzohen në adresën elektronike: **office@basketbolli.com** dhe duhet të përmbajnë:

- Të dhënat e organizatorit dhe përvojën në organizimin e ngjarjeve sportive;
- Planin organizativ dhe teknik, duke përfshirë vendin e propozuar për zhvillimin e eventit;
- Planin financiar dhe burimet e financimit për organizimin e eventit.

X. Bordi i FBK-së do të vlerësojë aplikimet duke marrë parasysh:

- Përvojën e organizatorit në organizimin e eventeve të ngjashme;
- Kapacitetet infrastrukturore dhe teknike;
- Planin financiar dhe garancinë për mbulimin e shpenzimeve.


XI. FBK rezervon të drejtën që, para marrjes së vendimit përfundimtar, të kërkojë informata shtesë ose të realizojë inspektim të objektit të propozuar për zhvillimin e eventit.

XII. Federata rezervon të drejtën për të refuzuar çdo aplikim që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, si dhe të anulojë ose rishpallë konkursin në rast se aplikimet nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

XIII. Për informata dhe sqarime shtesë lidhur me këtë konkurs, palët e interesuara mund të kontaktojnë në adresën elektronike: **office@basketbolli.com.**

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

